

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Qershor, 2018

Tiranë, më 23 Korrik 2018: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Qershor 2018, është 912.472, krahasuar me Qershor 2017, ky tregues rezulton me rritje 11,7 %.


Në Qershor 2018, numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 496.137. Krahasuar me Qershor 2017, ky numër është rritur me 13,3 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në gjashtëmuajorin e parë 2018 është 1.919.504 duke u rritur me 9,1 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në Qershor 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Maqedonia ka patur rritjen më të madhe me 58,3 %, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga Anglia me 10,9 %.

Në gjashtëmuajorin e parë 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe 26,4 % .

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Qershor 2018, janë 895.414 duke shënuar një rritje me 16,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Qershor 2018, është 411.165 krahasuar me Qershor 2017, ky numër është rritur 7,8 %. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Qershor 2018, është 484.249. Krahasuar me Qershor 2017, ky numër është rritur 23,9 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në gjashtëmuajorin parë 2018, është 2.396.317, duke u rritur 5,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Qershor-17	Qershor- 18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Qershor 17	Janar- Qershor 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje gjithsej	816,877	912,472	11,7	3.819.843	4.189.562	9,7
Shqiptarë	379.057	416.335	9,8	2.060.549	2.270.058	10,2
Të Huaj	437.820	496.137	13,3	1.759.294	1.919.504	9,1
Dalje gjithsej	771,980	895,414	16,0	4.001.427	4.361.461	9,0
Shqiptarë	381.246	411.165	7,8	2.263.581	2.396.317	5,9
Të Huaj	390.734	484.249	23,9	1.737.846	1.965.144	13,1

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Qershor -17	Qershor -18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Qershor 17	Janar- Qershor 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Kosovë	135.524	129.691	-4,3	568.776	566.263	-0,4
Maqedoni	52.888	83.734	58,3	246.524	284.758	15,5
Greqi	40.087	41.620	3,8	200.185	221.144	10,5
Itali	32.982	34.838	5,6	131.001	139.702	6,6
Angli	12.103	10.784	-10,9	42.901	43.374	1,1
Mali i zi	28.465	28.016	-1,6	172.083	178.195	3,6
Poloni	18.084	21.142	16,9	27.508	34.775	26,4
SHBA	12.640	13.909	10,0	35.885	40.948	14,1
Gjermani	13.292	13.589	2,2	41.080	48.701	18,6
Zvicër	3.423	3.151	-7,9	14.565	13.878	-4,7
Të tjera	88.332	115.663	30,9	278.786	347.766	24,7
Gjithsej	437.820	496.137	13,3	1.759.294	1.919.504	9,1

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Qershor		Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Qershor		Ndryshimi vjetor progresiv (%)
	-17	-18		-17	-18	
Hyrje Shtetas të Huaj	437.820	496.137	13,3	1.759.294	1.919.504	9,1
I. Personale	430.702	488.095	13,3	1.727.180	1.879.413	8,8
1. Pushime	195.048	249.438	27,9	561.967	566.068	0,7
2. Vizitë në miq e të afërm	1.038	1.673	61,2	5.292	6.524	23,3
3. Vizitë ditore	12.924	17.897	38,5	39.217	67.742	72,7
4. Trajtim shëndetësor	15	13	-13,3	259	124	-52,1
5. Qëllime fetare	62	58	-6,5	301	404	34,2
6. Vizitorë të tjerë	205.519	204.464	-0,5	1.043.437	1.159.706	11,1
7. Udhëtarë transit	16.096	14.552	-9,6	76.707	78.845	2,8
II. Biznes dhe profesionale	7.118	8.042	13,0	32.114	40.091	24,8

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Qershor 2017	119.849	69.116	627.912	104.364	61.666	605.950
Qershor 2018	148.773	75.882	687.817	128.896	65.968	700.550
Ndryshimi vjetor (%)	24,1	9,8	9,5	23,5	7,0	15,6
Janar-Qershor 2017	562.202	229.541	3.028.100	564.914	260.979	3.175.534
Janar-Qershor 2018	643.998	228.027	3.317.537	630.582	240.420	3.490.459
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	14,5	-0,7	9,6	11,6	-7,9	9,9

Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>